




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr. 06/L-114 neni 67, Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 neni 8, Udhëzimit Administrativ, 07/2017 neni 4 paragrafi 6 dhe 7 si dhe neni 6 paragrafi 5 nënparag. 5.1 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, rishpall :

KONKURSI BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Institucioni: Komuna e Gjilanit
Drejtoria: Drejtoria Komunale e Arsimit
Lloji i pozitës: Shërbimit Publik
Numri i pozitave: Pesë (5)
Orari i punës: 40 orë në javë
Titulli i mbikëqyrës Drejtori i Shkollës
Grada/Koeficienti: Paga bazë në SHFMU është A- 421
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar

Titulli i vendeve të punës:

Një (1) Mësimdhënës i Lëndës së Gjuhës Shqipe në SHFMU "Thimi Mitko" Gjilan
Një (1) Mësimdhënës i Lëndës së Kimisë, 18 orë mësimore në SHFMU "Zija Shemsiu" Gjilan
Një (1) Mësimdhënës i Lëndës së Gjuhës Shqipe, 10 orë mësimore në SHFMU "Musa Zajmi" Gjilan
Një (1) Mësimdhënës i Lëndës së Gjuhës Shqipe, 16 orë mësimore në SHFMU "Rexhep Elmazi" Gjilan
Një (1) Mësimdhënës i Lëndës së Gjuhës Shqipe në SHFMU "Esat Berisha" fsh. Llashticë.

Përshkrimi shkurtër i detyrave të punës:

- Punë kryesi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
- Të ketë njohuri për një repertor të gjerë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje ti aplikojë ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë;
- T'i shfrytëzoj në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion;
- Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgoj nxënien dhe sjelljen e secilit nxënësi;
- Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;

- Si dhe punët dhe detyrat tjera konform Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr.2015.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

1. Dëshmi mbi Kualifikimin – Përgatitja Adekuate Profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI Nr. 05/2021, Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm ;
2. Vërtetim mbi përvojën e punës në Arsimit;
3. Kopja e letërnjoftimit.

Informata të përgjithshme:

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga data : 09.06.2022 deri më : 23.06.2022.

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo t'i shkarkojnë nga ueb faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe të plotësuara si dhe të kompletuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në kuadër të Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme . Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> si dhe në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes email, njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit si dhe formave të tjera në pajtim me nenin 8 të UA 07/2017.

